



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Ilir Kosova" Sh.P.K. të datës 14.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 13.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje të teknologjisë informative" me nr. të prokurimit 616-23-1809-5-5-8 Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Ilir Kosova" Sh.P.K. e datës 14.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 13.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje të teknologjisë informative" me nr. të prokurimit 616-23-1809-5-5-8.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues për nënshkrim të kontratës duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën hyn në fuqi ky vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Ilir Kosova" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Ilir Kosova" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 14.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues rivlerësim të datës 13.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje të teknologjisë informative" me nr. të prokurimit 616-23-1809-5-5-8.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritu*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit është i cituar si në vijim: “Eliminimi i kompanisë tonë është bërë në mënyrë tendencioze dhe të pabazuar në rregullativën për prokurimin publik. Arsyetimi i parë i eliminimit është absolutisht i pabazuar dhe tendencioze në të njëjtën kohë pasi që të eliminohet kompania jonë për shkak të mos nënshkrimit të deklaratës nën betim në kolonën e duhur por është nënshkruar së bashku me vulën dy kolona më poshtë. Ky arsyetim është absolutisht i pabazuar në kërkesat për këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk ka mbështetje në asnjë dispozitë të LPP dhe RRPP. Arsyetimi i dytë është gjithashtu i pabazuar dhe tendencioze pasi që as nuk ka qenë kërkesë e juaj si AK dhe as nuk kërkohet me ndonjë dispozitë të LPP apo RRPP që autorizimi i kompanisë për punonjës të jetë i noterizuar. Për më tepër nuk ka arsye që të noterizohet një dokument zyrtar i lëshuar nga një subjekt juridik i nënshkruar dhe i vulosur nga personi përgjegjës”.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, dhe 59 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Pas njoftimit për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”), autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 25.03.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit e datës 03.03.2023;
- Oferta e dorëzuar nga tenderuesi (parashtruesi);
- Raporti i vlerësimit të tenderëve i datës 03.04.2023;
- Letra standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit e datës 06.04.2023;
- Përgjigja në letrën standarde për sqarimin e tenderit;
- B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 13.04.2023 së bashku me letrën standarde për tenderuesin e eliminuar;

Parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë provë për të mbështetur pretendimin e tij.

Pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet e parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafi d) të Rregullores (A01) nr.001/2022 për Prokurimin Publik (RRPP) sipas elaborimeve vijuese.

Sa i përket pjesës së parë të pretendimit, parashtruesi nuk e konteston faktin që deklarata për betim nuk është nënshkruar në pjesën e formularit që është e dedikuar për nënshkrim. Pra nuk është fare kontestuese që nënshkrimi në deklaratë nuk është vendosur në mënyrën e duhur. Për parashtruesin është kontestues vetëm fakti nëse vendosja e nënshkrimit në mënyrën e gabuar në deklaratën nën betim duhet të përbëjë një nga arsyet për eliminimin e tij nga ky aktivitet i prokurimit. Fillimisht duhet cekur se deklarata nën betim është dokument që kërkohet nga autoriteti kontraktues në kuadër të kërkesave të përshtatshmërisë dhe kualifikimit bazuar në nenin 64, 65, 66, et. al të LPP.

Përmes nenit 64 të LPP përcaktohet se tenderuesit duhet të plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas LPP. Kjo ndër të tjera nënkupton edhe plotësimi i dokumentacionit të kërkuar në mënyrën e duhur, aq më tepër kur bëhet fjalë për një nga dokumentet kryesore të tenderimit siç është 'Deklarata nën Betim'. Rëndësia e kësaj të fundit konfirmohet edhe RRPP përmes nenit 25 paragrafit 25.6 të RRPP lidhur me nenin 65 të LPP, pastaj me nenin 25 paragrafit 25.9 të RRPP lidhur me nenin 99 të LPP, etj. Me fjalë të tjera deklarata nën betim si e tillë dhe plotësimi i formularit përkatës në mënyrë precize dhe të duhur, përbën një kusht administrativ të domosdoshëm (*conditio sine qua non*). Në këtë drejtim përmes nenit 40 paragrafit 40.6 të RRPP përcaktohet se "*Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit*". Nga ky kënd i vështrimit, parashtruesi nuk ka arritur që të argumentoj përse eliminimi i tij qenka tendencioz ose i pabazuar siç pretendon ai. Me fjalë të tjera parashtruesi është dashur që të argumentoj se fakti që ai ka plotësuar në mënyrën e gabuar deklaratën nën betim, sipas pretendimit të tij është i pabazuar dhe tendencioz për cilat arsye ligjore?! Mirëpo parashtruesi jo vetëm që nuk ka arritur të argumentoj pretendimin e tij, por në vend të arsytimit edhe e ka pranuar faktin që nënshkrimi i vendosur në deklaratën nën betim është bërë në vend tjetër prej vendit të dedikuar për nënshkrim (duke e pranuar gabimin e bërë nga ai në mënyrë paradoksale). Në këtë mënyrë është gjetur se kjo pjesë e pretendimit të parashtruesit është mjaft kundërthënëse përbrenda vetes dhe si e tillë është e pabazuar në tërësi.

Në pjesën tjetër të pretendimit parashtruesi aludon se autorizimi që ka lëshuar vet parashtruesi për një nga punonjëset e kompanisë për të nënshkruar deklaratën nën betim nuk ka nevojë të jetë e vërtetuar nga noteri. Fillimisht duhet sqaruar se edhe këtu për parashtruesin nuk është fare kontestuese që nënshkrimi i deklaratës nën betim nuk është bërë nga drejtori menaxhues i kompanisë (parashtruesit). Kontestuese për parashtruesin është fakti nëse autorizimi që vet kompania (parashtruesi) e ka bërë për një person të tretë duhet të jetë i vërtetuar nga noteri ose jo për të qenë plotësisht i besueshëm për autoritetin kontraktues. Sikurse u tha edhe më sipër, deklarata nën betim e cila duhet të nëshkruhet nga drejtori menaxhues përkatësisht nga përfaqësuesi i autorizuar sipas ligjit ose me prokurë është kusht administrativ i domosdoshëm dhe i patejkalueshëm. Në pjesën e 10 përkatësisht në faqen 41 të Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik (tutje "UPP") përcaktohet se në rastet kur mungon ky kusht administrativ komisioni vlerësues duhet të refuzoj tenderin pa kërkuar fare informacione të mëtejshme. Kjo konfirmohet edhe përmes nenit 25 paragrafit 25.9 të RRPP ku thuhet se "*Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë*". Tutje sa i përket pikërisht kësaj dispozite, në faqen 28 të UPP përcaktohet se "*Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP*". Prandaj komisioni vlerësues nuk ka qenë fare i detyruar që të kërkoj sqarime shtesë lidhur me autorizimin përkatësisht prokuren që një person që nuk është drejtor menaxhues dhe as përfaqësues i autorizuar ka nënshkruar deklaratën nën betim të parashtruesit. Pra një veprim i tillë i komisionit vlerësues ka qenë tërësisht i panevojshëm në kuptim të dispozitës së sipërcituar të UPP.

Sidoqoftë, komisioni vlerësues me datë 06.04.2023 ka dërguar te parashtruesi letër standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit përmes së cilës i ka bërë me dije parashtruesit se deklarata nën betim nuk është nënshkruar nga pronari përkatësisht nga menaxheri apo përfaqësuesi i autorizuar. Rrjedhimisht është kërkuar nga parashtruesi autorizimi (prokura e veçantë) sipas të cilës personi që e ka nënshkruar deklaratën nën betim është autorizuar nga drejtori menaxhues për një veprim të tillë. Parashtruesi është përgjegjës në kërkesën e autoritetit kontraktues ashtu që ka dërguar një letër që e ka titulluar "Autorizim" i nënshkruar dhe vulosur nga z. Agron Dika (drejtor menaxhues) me tekstin si në vijim "Comtrade computers autorizon, Edona Konjusha me numër personal 1005352238 që gjatë vitit 2023 të nënshkruaj tender dokumentacionet dhe deklaratat nën betim në emër të kompanisë në fjalë".

Së pari, data që figuron në këtë letër është 05/01/2023 ndërsa aktiviteti i prokurimit është shpallur me datë 10.03.2023. Kjo nënkupton që ky "autorizim" është krijuar shumë kohë para se të shpallet aktiviteti i prokurimit. Sa i përket faktit që "autorizimi" i parashtruesit është disa muaj para datës kur është shpallur aktiviteti i prokurimit, duhet pasur parasysh që UPP në faqen 32 ka përcaktuar se "Periudha kohore e historikut për evidencën dokumentuese nën kërkesat e përshtatshmërisë kalkulohet nga data e publikimit të Njoftimit të Kontratës ose në rast të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës, data kur ftesa për pjesëmarrje është dërguar". Rrjedhimisht ky autorizim nuk mund të cilësohet asesi si evidencë dokumentuese lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë përkatësisht deklaratës nën betim për aktivitetin në fjalë të prokurimit.

Në cilindo rast ky autorizim nuk është dedikuar fare për aktivitetin e prokurimit ku ka ofertuar parashtruesi dhe aq më pak për të nënshkruar deklaratën përkatëse nën betim në mënyrë specifike. Pra nuk bëhet fjalë për prokurë të veçantë që është dhënë për personin në fjalë sikurse pretendohet. Kjo konfirmohet edhe nga vet përmbajtja e tekstit ku në asnjë rast nuk është cituar titulli i aktivitetit të prokurimit apo të paktën emri i autoritetit kontraktues dhe lëre më numri i prokurimit apo të dhënat tjera evidentuese sipas të cilave do të mund të kuptohej se përmes kësaj letre është autorizuar një person i caktuar me prokurë të veçantë për të kryer një punë juridike specifike.

Nuk është kontestues fakti që drejtori menaxhues ose përfaqësuesi i autorizuar i kompanisë janë personat që parimisht duhet të përfaqësojnë kompaninë në punë të tilla juridike sikurse që janë aktivitetet e prokurimit, procedurat doganore, tatimore, etj. Kjo konfirmohet edhe përmes nenit 109 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare ku thuhet se "Secili drejtor menaxhues është i autorizuar që ta përfaqësojë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar si Përfaqësues i Autorizuar gjatë ushtrimit të Veprimtarisë së saj Ekonomike, duke përfshirë edhe autorizimin: 1.1. për udhëheqjen e Veprimtarisë së zakonshme Ekonomike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; dhe 1.2. për nënshkrimin e marrëveshjeve ose dokumenteve tjera të nevojshme për ushtrimin e Veprimtarisë Ekonomike në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar...". Së pari duhet cekur se këtu kemi të bëjmë me veprimtari ekonomike të zakonshme prandaj është e domosdoshme prokura e veçantë (e cila mungon sipas elaborimeve më sipër).

Sidoqoftë nëse kuptojmë se drejtori menaxhuesi është i autorizuar për të përfaqësuar kompaninë Sh.P.K. përmes nënshkrimit të dokumenteve përkatëse në marrëdhëniet kontraktuese përkatësisht detyrimore atëherë duhet pasur parasysh edhe nenin 74 paragrafin 1 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku përcaktohet se *“Përfaqësuesi nuk mund të bëjë bartjen e autorizimeve ta veta në tjetrin, përveç nëse kjo i është lejuar me ligj ose me kontratë”*. Në rastin konkret ligji në kuptim të kësaj dispozite të LMD është ligji në fuqi për prokurimin publik i cili përmes nenit 64 lidhur me dëshmitë e kërkesave ka përcaktuar se *“Një kandidat ose tenderues do të dëshmojë me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të këtij ligji nuk zbatohen; (ii) të verifikojë përshtatshmërinë e tij profesionale, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji; (iii) i plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 68-71 të këtij ligji”*. Nga dispozita e sipërcituar e LPP fokusi duhet të përqëndrohet në pjesën e dispozitivit kur kërkohen nga tenderuesi **dëshmi të mjaftueshme** të kërkuara nga autoriteti kontraktues.

Summa summarum për të përmbledhur dispozitat ligjore të cituara dhe elaboruara më sipër, parashtruesi në cilësinë e tenderuesit nuk e ka nënshkruar deklaratën nën betim (kusht administrativ i domosdoshëm) nga përfaqësi i autorizuar përkatësisht drejtori menaxhues. Ky i fundit pretendon që e ka bartur këtë autorizim te një person i tretë, e cila bartje nuk është në përputhje me LMD (dispozitën e sipërcituar). Në vazhden e kësaj LPP ka përcaktuar se tenderuesi (parashtruesi) është i detyruar që të ofroj dëshmi të mjaftueshme për autoritetin kontraktues lidhur me ligjshmërinë e nënshkrimit të deklaratës nën betim. Nga ky këndvështrim duhet theksuar se letra që parashtruesi e quan “autorizim” jo vetëm që nuk i referohet aktivitetit përkatës të prokurimit dhe nuk përputhet as për nga datat, por as nuk është e vërtetuar te noteri për t’i dhënë kësaj letre fuqinë e një dokumenti zyrtar. Megjithëse parashtruesi në pretendimin e tij thotë se *“nuk ka arsye që të noterizohet një dokument zyrtar i lëshuar nga një subjekt juridik”*, duhet cekur se sipas nenit 3 paragrafit 3 të Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë përcaktohet se *“Dokumentet noteriale të lëshuara sipas këtij ligji kanë fuqinë e dokumenteve publike, nëse me rastin e hartimit dhe lëshimit të tyre janë plotësuar formalitetet themelore të parapara me ligj. Dokumenti noterial ka fuqinë provuese...”*. Një fakt notor që parimisht nuk ka nevojë as të shpjegohet është se asnjë drejtor menaxhues në asnjë Sh.P.K. nuk e ka fuqinë të prodhojë dokumente publike (zyrtare) sikurse pretendon parashtruesi. Megjithatë për çdo është cituar edhe dispozita më sipër nga ligji për noterinë ku konfirmohet se një dokument privat do të merr fuqinë e dokumentit publik atëherë kur do të noterizohet nga noteri. Njëkohësisht konfirmohet se ky dokument noterial si i tillë do të ketë edhe *fuqinë e nevojshme provuese* në procedura përkatëse juridike. Pikërisht kjo pjesë e dispozitës ku potencohet fuqia provuese e dokumentit noterial është në harmoni të plotë edhe me nenin 64 të LPP ku thuhet se tenderuesi duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme për kërkesat e autoritetit kontraktues (në këtë rast për autorizim e parashtruesit për nënshkrimin e deklaratës nën betim nga një person i tretë).

Lidhur me këtë çështje vlen të citohet edhe neni 3 paragrafi 4 i ligjit për noterinë ku thuhet se *“Vërtetësia dhe zbatueshmëria e dokumenteve të noterizuara bazohet në nënshkrimin, formën dhe përmbajtjen e dokumentit. Dokumentet e noterizuara gëzojnë supozimin e dyfishtë të ligjshmërisë. Ato mund të kontestohen vetëm përmes procedurave gjyqësore”*. Prandaj parashtruesi është dashur jo vetëm që të ofroj një autorim (prokurë) të veçantë për aktivitetin përkatës të prokurimit dhe punën juridike specifike për të cilën autorizohet personi i tretë, por njëkohësisht është dashur që të sigurohet se ky autorizim është i noterizuar nga noteri në emër të *“dëshmisë së mjaftueshme”* për autoritetin kontraktues.

Duhet kuptuar po ashtu se në aktivitetet e prokurimit ku Komuna e Prishtinës është autoritet kontraktues, synohet të nënshkruhet një kontratë (*justus titulus*) si detyrim të dyanshëm me shpërblim (*inter partes*) ku njëra palë është autoritet publik (Komuna e Prishtinës si AK) e cila ka fuqinë që të prodhoj dokumente publike (për dallim nga kompanitë private siç është parashtruesi). Në këtë drejtim LMD përmes nenit 78 ka përcaktuar se *“Forma e parashikuar me ligj për ndonjë kontratë ose për ndonjë punë tjetër juridike vlen edhe për prokurën që jepet për lidhjen e kësaj kontrate, përkatësisht për ndërmarrjen e kësaj pune juridike”*. Kjo nënkupton se në rastin përkatës ku autoritet kontraktues është institucioni publik (Komuna e Prishtinës), një autorizim i tillë për të cilin bëhet fjalë duhet të ketë fuqinë e dokumentit publik. Kjo mund të arrihet vetëm përmes noterizimit në përputhje me nenin 3 paragrafët 3 dhe 4 të ligjit për noterinë sikurse të cituar si më sipër.

Në vazhden e elaborimeve më sipër, duhet shtuar se përmes nenit 67 të LPP lidhur me provat shkresore që dorëzohen nga operatorët ekonomik përcaktohet se *“KRPP-ja duhet të sigurojë që rregullat në fjalë në masë të arsyeshme tu lejojnë operatorëve ekonomik paraqitjen e deklaratave nën betim, deklaratave të noterizuara e të ngjashme”*. Me fjalë të tjera edhe sipas legjislacionit sekondar në fuqi të miratuar nga KRPP janë përcaktuar masat e arsyeshme për operatorët ekonomik që të noterizojnë deklaratat e tyre (përkatësisht autorizimi për të cilin bëhet fjalë në rastin konkret lidhur me deklaratën nën betim). Kjo konfirmohet edhe sipas nenit 25 paragrafit 25.7 të RRPP ku thuhet se *“Operatorët ekonomik janë të obliguar nga autoriteti kontraktues për të paraqitur dëshmi dokumentuese të përshatshmërisë profesionale”*. Nëse fokusohemi te termi *“dëshmi dokumentuese”* të cilit i referohet kjo dispozitë atëherë logjikisht do të konstatohet se një autorizim i cili nuk është noterizuar mirëpo është lëshuar nga vet kompania (parashtruesi) në formë të një dokumenti të brendshëm (privat) që nuk është as prokurë e posaçme sepse nuk përputhet as nga datat dhe as nuk i referohet fare aktivitetit përkatës të prokurimit dhe mbi të gjitha është i panoterizuar nga noteri, si i tillë as ligjërisht dhe as logjikisht kjo shkresë e parashtruesit nuk ka pasur si të cilësohet nga komisioni vlerësues si *“dëshmi dokumentuese”* dhe aq më pak si dëshmi e mjaftueshme sikurse përcaktohet me këtë dispozitë të RRPP lidhur me nenin 64 të LPP. Prandaj vendimi i autoritetit kontraktues në këtë rast sipas gjetjeve përkatëse në raportin e komisionit vlerësues rezultojnë të jenë plotësisht të bazuara në legjislacionin përkatës në fuqi dhe të argumentuara mjaftueshëm.


Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.04.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.